



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 185, Datë 21.07.2022**

**MBI**

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR  
SHËRBIMIN E SISTEMIT TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 16 pika 1, 17 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1144 prot., datë 19.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Drejtoria Gazit Natyror “Mbi miratimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror”,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin e bordit nr. 107, datë 19.05.2022, ERE vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror”.
- Me shkresën nr. 70/24 prot., datë 01.06.2022, u publikua njoftimi në median e shkruar për 2 ditë me radhë në Gazetat “Tema” dhe “Panorama”, me qëllim mbledhjen e opinionëve dhe sugjerimeve nga palët e interesit.
- Me shkresën nr. 288 prot., datë 06.06.2022, ERE i kërkoi palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar (SHMKSH), Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK), Shoqatës “Konsumatori në fokus”, Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale (IDP), “Albpetrol” sh.a., “Albgaz” sh.a., “Phoenix Petroleum” sh.a., “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “TAP AG Albania” sh.p.k., “GSA” sh.p.k., dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të dërgojnë opinionet dhe sugjerimet në lidhje me këtë metodologji.
- Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale me shkresën nr. 1153/1 prot., datë 24.06.2022, protokolluar në ERE me shkresën nr. 88/1 prot., datë 28.06.2022, shprehet se akti nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në

kompetencë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Nuk ka patur propozime të tjera nga palët e interesit të sipërcituara.
- Metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror, ka si qëllim përcaktimin e kritereve, kushteve dhe mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror, bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me aktet rregullatore të miratuara nga ERE, të realizuar nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror.
- Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën e Normës së Kthimit të Pritshme të Investimit (RoR). Operatorit të Sistemit të Depozitimit do t'i lejohet të mbulojë kostot e shërbimit si dhe një kthim mbi investimin. Pas hyrjes në operim, nëse periudha rregullatore do të jetë më shumë se një vit, atëherë përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën e “Price Cap”/ “Çmim Tavan”.
- Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit do të vendosen sipas parimit të kostove të drejta dhe të arsyeshme dhe duhet të nxisin përdorimin me efikasitet të aseteve të hapësirave të depozitimit.
- Operatori i Sistemit të Depozitimit do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror (GN)”. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

## **METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E SISTEMIT TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR**

### **Neni 1 Baza Ligjore**

Kjo metodologji hartohet në zbatim të nenit 17 dhe neneve 16 pika 1 dhe 32 pika 1 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”.

### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i kriterëve, kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e Sistemit të Depozitimit të Gazit Natyror (injektimin, depozitimin dhe terheqjen e gazit natyror), bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim dhe që realizohen nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

### **Neni 3 Fusha e zbatimit**

- 3.1 Kjo metodologji përcakton tarifën e shërbimit të depozitimit të gazit natyror dhe zbatohet nga Operatorët e Sistemit të Depozitimit, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, dhe që;
- a) kryejnë veprimtarinë e depozitimit dhe janë përgjegjës për Operimin e impianteve të depozitimit të gazit natyror sipas nenit 59 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
  - b) kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me nënë 11 dhe nënë 59 të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar;
  - c) zbatojnë rregulla të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit përdoruesve të impiantit të depozitimit dhe që janë subjekt monitorimi nga ERE, sipas nenit 64, shkronja c) të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar;
  - d) ofrojnë, për përdoruesit e impiantit të depozitimit, shërbime të ndara dhe të pandara të hapësirës së depozitimit, injektimit dhe terheqjes së gazit natyror, sipas kontratave të

nënshkuara, mbështetur në nenin 67 të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar;

#### **Neni 4** **Përkufizime**

Termat e përgjithshëm të përdorura në këtë metodologji janë sipas Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, dhe kanë kuptimet e mëposhtëme:

**“Depozitim”** është procesi i injektimit të gazit natyror në hapësirat depozituese, depozitimi dhe marrja e tij nga këto hapësira. Depozitimi në formacionet e kripëzuara, në vëndburimet e shteruara, në shtresat ujore ose funde tubacionesh.

**“Operator i Sistemit të Depozitimit”** është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin e hapësirave të depozitimit.

**Hapësirë”** është sasia ose volumi i gazit që i lejohe përdoruesit të depozitojë në impiantin e depozitës.

**“Hapësirë depozitimi”** është hapësira e përdorur për depozitimin e gazit natyror, që zotërohet dhe/ose operohet nga një shoqëri e gazit natyror, përfshirë pjesën e impianteve të GNL-së, të përdorura për depozitim, duke përjashtuar ato impiante GNL-je që përdoren për veprimtarinë e prodhimit dhe hapësirat e rezervuara ekskluzivisht për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) në kryerjen e funksioneve të tij.

**“Hidrokarbur”** është nafta bruto dhe/ose gazi natyror.

**“Injektueshmëri”** është raporti në sasinë e gazit që lejohe të injektohet në depozitë nga ana e përdoruesit të impiantit të depozitës.

**“Metodologji e tarifave”** është akti që përcakton kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të veprimtarive të rregulluara të gazit natyror.

**“Tarifë”** është çmimi i shërbimit të ofruar nga subjektet që kryejnë veprimtari të rregulluara për aksesin në hapësirat e depozitimit, i vendosur në bazë të metodologjisë së llogaritjes së tarifave.

**“Periudha e tarifimit”** nënkupton afatin kohor për të cilat janë vendosur tarifat.

**“Periudha rregullatore”** është periudha për të cilën tarifat e reja hyjnë në fuqi dhe rregullohen sipas vendimit të marrë nga Enti Rregullator i Energjisë, pas një shqyrtimi të plotë dhe të detajuar të aplikimit të tarifave të paraqitura nga Operator i Sistemit të Depozitimit dhe nënkupton periudhen kohore për të cilën janë përcaktuar të ardhurat e lejuara;

**“Te ardhurat e lejuara”** janë të ardhurat nga operatori i sistemit të depozitimit të gazit natyror tek shërbimi i sistemit të depozitimit të gazit natyror, që mbulon kostot e justifikuara nga ana ekonomike dhe teknologjike dhe për të cilat operatori i sistemit ka të drejtë të marrë gjatë periudhës specifike rregullatore;

**“Viti bazë”** është viti i parë i periudhës rregullatore.

**“Viti i testimi”** është një periudhë 12 mujore përpara periudhës rregullatore, e cila përdoret si bazë e përcaktimit të të ardhurave të kërkuara për vitin bazë.

**“Konsumi i gazit natyror për nevojat teknologjike”** – nënkupton gazin natyror që përdoret për të siguruar proceset teknologjike të hapësirave të depozitimit;

**“Humbjet e gazit natyror”** do të thote diferenca midis vëllimeve të gazit të injektuara në hapësirat e depozitimit dhe që tërhiqen nga hapësira e depozitimit gjatë ciklit të depozitimit, duke përjashtuar konsumin e gazit natyror për nevojat teknologjike;

**“Kapacitet”** është sasia maksimale injektimit/tërheqjes së rrjedhjes së gazit, e shprehur në metër kub për njësi normale ose në njësi energjie për çdo njësi kohe, që i është dhënë çdo përdoruesi të rrjetit, sipas kontratave të lidhura me Operatorin e Sistemit të Depozitimit si dhe/ose sipas kontratës së transportit të lidhur me OST-në.

**“Kapacitet i kontraktuar”** është kapaciteti i depozitimit për çdo lloj kontrate të lidhur respektivisht me përdoruesit e rrjetit dhe Operatorin e Sistemit të Depozitimit si dhe/ose kontratës së lidhur me OST.

**Kapacitete i ndërprerë”** është kapaciteti, i cili mund të ndërpritet nga OST-ja apo Operatori i Sistemit të Depozitimit, sipas kushteve për të cilat është rënë dakord në kontratën e transportit të lidhur me OST-në apo me Operatorin e Sistemit të Depozitimit.

Kapacitet i pandërprerë është kapaciteti që u vihet në dispozicion përdoruesve të rrjetit nga Operatori i Sistemit të Depozitimit për çdo ditë të depozitimit të gazit për një vit të dhënë (sipas kontratës së lidhur midis përdoruesve të rrjetit dhe Operatorit të Sistemit të Depozitimit).

**“Shërbimi për rezervimin e kapacitetit”** është shërbimi i sistemit të depozitimit që siguron rezervimin e produktit për kapacitetin e depozituar për depozitimin e gazit natyror dhe injektimin dhe tërheqjen e gazit natyror në / nga hapësirat e depozitimit;

**“Shfrytëzim i kapacitetit të parashikuar të hapësirave të depozitimit”** nënkupton kapacitetin mesatar të depozitimit i përdorur tek tre ciklet e mëparshme të depozitimit. Nëse kapaciteti teknik i hapësirave të depozitimit është përdorur plotësisht për ndonjë nga tre ciklet e mëparshme të depozitimit, kur të përcaktohet shfrytëzimi i hapësirave të depozitimit për këtë cikël depozitimi, duhet të përdoret parashikimi i kapacitetit teknik për ciklin e depozitimit, në të cilat është planifikuar të fillojë aplikimi i rregullave;

**“Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)”** do të thotë asetet e operatorit të sistemit të depozitimit ose një pjesë të tij të cilat janë të nevojshme për ofrimin efiçent të shërbimit të depozitimit të sistemit.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë metodologji do të ketë kuptimin si përcaktuar në ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

## **Neni 5**

### **Parimet e vendosjes së Tarifave**

- 5.1 Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën e Normës së Kthimit të Pritshme të Investimit (RoR). Operatorit i Sistemit të Depozitimit do t’i lejohet të mbulojë kostot e shërbimit si dhe një kthim mbi investimin. Pas hyrjes në operim, nëse periudha rregullatore do të jetë më shumë se një vit, atëherë përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën e “Price Cap”.
- 5.2 Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit do të vendosen sipas parimit të kostove të drejta dhe të arsyeshme dhe duhet të nxisin përdorimin me efiçencë të asetëve të hapësirave të depozitimit.
- 5.3 Operator i sistemit të Depozitimit do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE.
- 5.4 ERE do të miratojë tarifën e shërbimit të depozitimit për operatorin e sistemit të depozitimit kur të plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie.
- 5.5 Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit të miratuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1 vjeçare), për periudhën e parë

rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

- 5.6 Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të Operatorit të Sistemit të Depozitimit, përveç rasteve kur është e justifikuar për arsye madhore.
- 5.7 Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin Sistemit të Depozitimit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të argumentuara që Operatori i Sistemit të Depozitimit përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji.
- 5.8 Kostot dhe tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit do të llogariten në bazë të të dhënave të përfituara nga viti i mëparshëm i aktivitetit të operatorit të rrjetit.
- 5.9 Për operatorin e shërbimit të depozitimit i cili operon për herë të parë, vlerësimi i kostove të shërbimit të depozitimit për periudhën pasardhëse do të mbështetet bazuar në realizimin dhe parashikimin e kostove dhe shpenzimeve të argumentuara për vitin aktual.
- 5.10 Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit do të pasqyrojnë kostot e shërbimit.
- 5.11 Kostot e lejuara që kanë shërbyer për përcaktimin e tarifave së shërbimit të depozitimit publikohen nga ERE për arsye të transparencës ndaj të gjithë përdoruesve.
- 5.12 Operatori i sistemit do të përgatisë propozimin e tarifës në përputhje me këtë Metodologji, duke përcaktuar të ardhurat që janë të nevojshme për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit për rezervimin e kapacitetit.
- 5.13 Operatori i sistemit do të llogarisë tarifën në mënyrë që të ardhurat e lejuara nga shërbimi për rezervimin e kapacitetit të mos kalojnë kostot e justifikuara të operatorit të sistemit që janë ndarë për shërbimin e rezervimit të kapacitetit.
- 5.14 Në zbatim të parashikimeve të “Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE” operatori i sistemit të depozitimit do të paraqesë për shqyrtim në ERE aplikimin për miratimin e tarifave të depozitimit të gazit natyror me shkrim si dhe llogaritjet e tarifave dhe kostot e tyre në formë elektronike. Në aplikimin e tarifave operatori i sistemit të depozitimit duhet të paraqesë:

- a) propozimin e tarifave dhe kostot përkatëse për periudhën e ardhshme rregullatore, duke filluar nga dita kur planifikohet të fillojë aplikimi i tarifave të llogaritura,
- b) arsyetimin për kostot që formojnë tarifën e referuara në llogaritjen e propozuar të tarifave si dhe dokumentet që vërtetojnë kostot e lartpërmendura në përputhje me parashikimet e kësaj metodologjie;
- c) shfrytëzimin e parashikuar të kapacitetit të hapësirës së depozitimit, që ndahet për secilën nga produktet e kapacitetit, si dhe arsyetimin përkatës;
- d) arsyetimet dhe vlerësimet mbi koeficientët e specifikuar në nenin 11 të kësaj Metodologjie për:
  - kapacitetit të injektimit të gazit natyror
  - kapacitetit të depozitimit të gazit natyror
  - kapacitetit të tërheqjes të gazit natyror

5.15 Operatori i sistemit të depozitimit, duhet të përcjellë për shqyrtim koeficientët e përmendur në gjermën d) të pikës 5.16 të këtij neni pranë ERE të shoqëruar me vlerësim dhe arsyetimet përkatëse për përlllogaritjen e tyre përgjatë periudhës rregullatore jo më vonë se 6 muaj para fillimit të periudhës rregullatore gjatë së cilës është planifikuar të aplikohen.

5.16 Tarifën e propozuar do të zbatohet për periudhën e parë të operimit, deri në maturimin e produktit të kapacitetit. Për periudhat e ardhshme kur të maturohet produkti i kapacitetit do të llogariten tarifa të ndara (për kapacitet të ndërprerë dhe për kapacitet të pandërprerë).

## **Neni 6**

### **Të ardhurat e kërkuara për shërbimin e depozitimit**

6.1 Të Ardhurat e Kërkuara llogariten çdo vit dhe përfshijnë kostot operative dhe kapitale të aktivitetit të depozitimit bazuar në informacionin kontabël sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

6.2 Të ardhurat e kërkuara për mbulimin e shërbimit të depozitimit të gazit natyror për çdo vit të periudhës rregullatore, do të jenë të barabarta me shumën e:

- a) kthimit mbi kapitalin e investuar neto të njohur nga rregullatori;
- b) amortizimin;
- c) kostove të njohura të operimit (OPEX);

6.3 Në rast se ofrimi i shërbimit fillon gjatë vitit, vlera e të ardhurave të njohura përcaktohet në përputhje me ditët në të cilat shërbimi vihet aktualisht në dispozicion.



6.4 Operator i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror gjatë procesit të aplikimit për tarifë duhet të paraqesi diferencat në të ardhurat e kërkuara që rezultojnë me të ardhurat e lejuara, për rezultatet paraprake në lidhje me vitin t-1. Këto diferenca në (+) ose (-) që vijnë nga periudhat e mëpareshme rregullatore do të konsiderohen si të arësyeshme dhe do të përfshihen në të ardhurat e kërkuara të periudhës që rishikohet t.

## Neni 7

### Kthimi në Kapitalin e Investuar

7.1 Njohja e vlerës së aseteve fikse bëhet me kusht që investimet përkatëse të jenë në përputhje me efikasitetin dhe sigurinë e sistemit.

7.2 Për qëllimin e përcaktimit të kapitalit të njohur neto të investuar për vitin e testimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror:

- a) Llogaritet vlera e aseteve fikse neto;
- b) Shtohet vlera e kapitalit të punës neto, ose 1/12 e OPEX-it në mungesë të kostove historike;
- c) Zbritet vlera e aseteve të përfituara nëpërmjet dhurimit ose të ndërtuara me burime financiare të konsumatorëve të gazit të lëngshëm;
- d) Zbritet vlera e granteve kapitale të disbursuara në çdo vit nga organet publike ose private për ndërtimin e infrastrukturës.

7.3 Për qëllimin e përcaktimit të vlerës së aseteve fikse neto për Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror do të zbatohet formula:

$$\mathbf{RAB = As + Bs + INV - D}$$

ku:

**As** - do të jetë vlera e mbetur e aseteve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin në hapësirat depozitimit të llogaritura me koston historike të blerjes në fillim të periudhës rregullatore në vitin (t-2), sipas PF të audituara;

**Bs** - vlera e aseteve që priten të hynë në operim në vitin (**t-1**);

**INV** - shtesat e reja të investimeve që parashikohen të realizohen në vitin (**t**);

**D** - do të llogaritet vlera e amortizimit, sipas metodës së jetëgjatësisë së asetit.

7.4 Gjatë periudhës rregullatore pas vitit të testimit, pjesa e të ardhurave që mbulon kthimin e kapitalit të njohur të investuar përditësohet duke marrë parasysh:

- a) investimet e hyra në operim gjatë vitit paraardhës të vitit të paraqitjes së propozimit tarifor t-1;

- b) investimet që pritet të hyjnë në operim në vitin e prezantimit të propozimit të tarifave në bazë të rezultateve paraprake;
- c) grante per shpenzime kapitale të marra për realizimin e investimeve;
- d) rritjen e amortizimit në bazë të jetëgjatesise të aseteve fikse.

7.5 Kthimi i lejuar mbi kapitalin pas taksave do të merret norma bazë e interesit si dhe një premium për riskun specifik të Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror. Norma bazë e interesit merret vlera e bonove të thesarit të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

7.6 Kthimi mbi kapitalin pas taksave do të vendoset nga ERE, dhe do të publikohet në fillim të vitit në të cilin Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror fillon aktivitetin.

## **Neni 8**

### **Amortizimi i lejuar**

8.1 Për qëllimet e përcaktimit të amortizimit të lejuar për vitin **t**, Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror:

- a) llogarit asetet fikse bruto të kategorive individuale të aseteve në operim deri më 31 dhjetor të atij viti;
- b) zbret nga asetet fikse bruto të kategorive individuale të aseteve të përfutuara nëpërmjet granteve;
- c) përcakton amortizimin vjetor si një raport i vlerës së përmendur në shkronjën (a) dhe (b), për secilën kategori të asetit, ndaj jetëgjatësisë së asetit ose jetëgjatësisë së përcaktuar nga Rregullatori;
- d) shton amortizimin vjetor të përmendur në shkronjën (c) amortizimit të akumuluar për periudhat paraardhëse.

## **Neni 9**

### **Kostot operative**

9.1 Pjesa e të ardhurave për të mbuluar kostot operative përcaktohet, për vitin kur Metodologjia të jetë e aplikueshme nga shoqëritë, në bazë të kostove operative të shkaktuara nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror. Kostot aktuale të operimit përfshijnë të gjithë zërat e kostove të një natyre të përsëritur, faktike dhe që i atribuohen shërbimit të depozitimit të gazit natyror dhe përcaktohen në bazë të llogarive vjetore sipas Pasqyrave Financiare të Audituar.

9.2 Në rast të diferencave të konsiderueshme të tepërta ndërmjet zërave të kostove të kërkuara për periudhën rregullatore dhe atyre të ndodhura në vitet e mëparshme dhe ku nuk justifikohen nga

kompania që ushtron rolin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit të gazit natyror, kostot aktuale të funksionimit, do të përcaktohen bazuar në një mesatare të këtyre kostove në vitet e mëparshme duke përjashtuar ato kosto që nuk kanë natyrë përsëritëse dhe që nuk janë të argumentuara apo të arsyeshme.

9.3 Kostot aktuale do të llogariten sipas fomulës:

**OPEX= C mirëmbajtje + C paga + C përgjithshme + C energji elektrike + C injektimit +C tërheqjes + C Konsumi teknologjik dhe humbjet në procesin e depozitimit**

Ku:

**C mirëmbajtje** - përfshin kostot e operimit (mirëmbajtje, shërbime, riparime dhe të tjera);

**C paga** - përfshin kostot e operimit (kostot e personelit);

**C përgjithshme** - përfshin shpenzime të përgjithshme (qira, sigurime dhe të tjera);

**C energji elektrike** - përfshin kostot e energjisë elektrike;

**C injektimit** – përfshin koston e injektimit të gazit natyror në hapësirat e depozitimit

**C tërheqjes** – përfshin koston e tërheqjes së gazit natyror nga hapësirat e depozitimit

**C proceseve teknologjike dhe humbjet në procesin e depozitimit** - kostot për të mbuluar vetëkonsumin dhe humbjet në procesin e depozitimit të gazit natyror.

Kostot për humbjet e gazit natyror dhe për ofrimin e proceseve teknologjike do të përcaktohen duke përdorur formulën e mëposhtme:

$C \text{ proceseve teknologjike dhe humbjet në procesin e depozitimit} = (P + K) \times \text{Ç}$

ku:

P – humbjet e planifikuara të gazit natyror [kWh ose Nm<sup>3</sup>];

K – konsumi i planifikuar i gazit natyror për nevoja teknologjike [kWh ose Nm<sup>3</sup>];

Ç – çmimi mesatar i planifikuar për humbjet e gazit natyror [EUR/kWh ose EURO/ Nm<sup>3</sup>].

Në përllogaritjen e kostos së operimit të hapësirës së depozitimit, operatori i sistemit mund të marrë parasysh inflacionin e planifikuar për vitet e përfshira tek periudha përkatëse rregullatore. Operatori i sistemit duhet të paraqesë arsyetimin për inflacionin e planifikuar të përdorur për indeksimin e kostove të operimit.

Kostot për të siguruar proceset teknologjike nuk do të përfshijnë kostot e gazit natyror që përdoren për të ofruar operimin e kompresorëve.

Për vitin e parë të operimit me qëllim që ERE të vlerësojë nëse këto kosto janë të arsyeshme dhe të justifikuar, Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror duhet të përcjellë, një benchmark të kostove të përmendura në pikën 9.3 të realizuara nga shërbimi depozitimit nga operatorë të ngjashëm që operojnë në rajon apo më gjërë.

9.4 Pjesa e të ardhurave totale të kërkuara për shërbimin e depozitimit që i atribuohen kostove operative:

- a) për vitin e parë të ofrimit efektiv të shërbimit të depozitimit, të ardhurat e kërkuara propozohen nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror dhe i nënshtrohen verifikimit nga ERE. Ky propozim duhet të përfshijë të dhëna të krahasueshme ose dëshmi që provojnë përpjekjet për minimizimin e kostove si dhe:
  - i. dallimin, për secilin zë të kostos operative, midis kostove fikse dhe variabile,
  - ii. çdo dallim midis kostove operative që i atribuohen drejtpërdrejt funksionimit impiantit ndaj kostove të tjera;
- b) për periudhën rregullatore pas fillimit të ofrimit të shërbimit, këto kosto përcaktohen duke filluar nga vlerësimi i propozuar nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror, nga disponueshmëria e të dhënave përfundimtare në lidhje me kostot aktuale të funksionimit që mund të nxirren nga Pasqyrat Financiare që përfaqëson të dhëna financiare të paraqitura sipas **“Sistemit të Njësuar të Llogarive për Shoqëritë e Transmetimit dhe Depozitimit në Sektorin e Gazit Natyror”**.

9.5 Në rastet kur periudha rregullatore është disa vjeçare atëherë tarifa e shërbimit të depozitimit të gazit natyror për Operatori i Sistemit të Depozitimit për vitet pas vitit bazë do të korrigohet për çdo periudhë tarifore brenda periudhës rregullatore duke konsideruar korigjimin lidhur me:

- diferenca ndërmjet të ardhurave të planifikuara dhe atyre aktuale, duke përfshirë pagesat e përdoruesve të sistemit të gazit natyror të specifikuar në Rregulloret e depozitimit për ankandet e rezervimit të kapacitetit të ruajtjes ose aktivitete të tjera që lidhen me ofrimin e shërbimeve të rezervimit të kapacitetit nga operatori i sistemit të depozitimit;
- diferencat ndërmjet kostove të planifikuara dhe kostove faktike të cilat përshijnë dhe kostot e shkaktuara nga ngjarje dhe ndryshime të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara.

9.6 Operatori i Sistemit të Depozitimit duhet të demonstrojë se këto kosto janë të ndryshme krahasuar me kostot aktuale të konsideruara në vitin bazë, po ashtu duhet të demonstrojë paparashikueshmërinë aktuale dhe natyrën e jashtëzakonshme të ngjarjeve të konsideruara; dhe të demonstrojë çdo aktivitet të ndërmarrë, kostot përkatëse në vitin bazë, si dhe aktivitetet shtesë që bëhen të nevojshme në zbatim të Akteve Ligjore.

## Neni 10

### Investimet e reja lidhur me shtesat e kapacitetit të depozitimit

- 10.1 Për qëllimet e njohjes së investimeve të bëra në të ardhurat e kërkuara, Operatorit të sistemit të depozitimit i cili parashikon të ndërtojë një sistem të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, i kërkohet të paraqesë një analizë kosto-përfitim të investimit tek ERE, të zhvilluar në përputhje me kriteret e përgjithshme të rregullores së paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror dhe duke u mbështetur në udhëzimet e përcaktuara nga aktet rregullatore për vlerësimin e ndërhyrjeve të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror.

ERE pas vlerësimeve të këtyre investimeve do të vendosë nëse do të pranojë ose jo pëfshirjen e tyre në tarifë në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri midis nivelit të shërbimit të kryer dhe nivelit të kthimit të njohur.

- 10.2 Për qëllime të llogaritjes së të ardhurave të kërkuara për mbulimin e CAPEX për vitin e parë të shërbimit të depozitimit t, shoqëria që ushtron aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit do të llogarisë kthimin e kapitalit neto të investuar dhe amortizimin bazuar në vlerën e aseteve fikse në operim të reflektuara në pasqyrat financiare dhe parashikimin për vitin aktual.

## Neni 11

### Llogaritja e tarifës për shërbimin e depozitimit të gazit natyror

- 11.1 Tarifa e shërbimit të depozitimit të gazit natyror për operatorin sistemit të depozitimit do të përllogaritet sipas formulës në vijim:

$$TD = C_s \times S + C_i \times I + C_e \times E$$

Ku:

$C_s$  – vlera e shprehur në Lekë/MWh/vit ose Lekë/Nm<sup>3</sup>/vit e hapësirës së depozitimit

$S$  – kapaciteti i hapësirës së depozitimit në bazë vjetore në dispozicion për përdoruesin e shërbimit të depozitimit e shprehur në MWh/vit ose Nm<sup>3</sup>/vit

$C_i$  – vlera e shprehur në Lekë/MWh/ditë ose Lekë/Nm<sup>3</sup>/ditë e kapacitetit të injektimit në hapësirat e depozitimit

$I$  – kapaciteti i injektimit në baza vjetore në dispozicion për përdoruesin e shërbimit të depozitimit e shprehur në MWh/ditë ose Nm<sup>3</sup>/ditë

$C_e$  – vlera e shprehur në Lekë/MWh/ditë ose Lekë/Nm<sup>3</sup>/ditë e kapacitetit të tërheqjes së gazit natyror nga hapësirat e depozitimit

E – kapaciteti i tërheqjes në baza vjetore në dispozicion për përdoruesin e shërbimit të depozitimit e shprehur në MWh/ditë ose Nm<sup>3</sup>/ditë

11.2 Vlerat e shprehura për secilin nga aktivitetet e shërbimit të depozitimit përlogariten për çdo vit tarifor si më poshtë:

$$c_s = \alpha_s \times \frac{A}{S}$$

$$c_I = \alpha_I \times \frac{A}{I}$$

$$c_E = \alpha_e \times \frac{A}{E}$$

$$A = TA - TAs$$

Ku:

A-e ardhura totale e kërkuar (OPEX+CAPEX)

TA – janë të ardhurat e kërkuara të shërbimit të depozitimit të gazit natyror të vitit tarifor

TAs – janë të ardhurat që pritet të realizohen nga shërbimi i depozitimit të gazit natyror të cilat do të rekuperohen prej rezervës strategjike në pronësi të Operatorit të Sistemit të Depozitimit gjatë vitit tarifor e përlogaritur prej kthimit të kapitalit të investuar dhe vlerës monetare të sasisë së gazit natyror të rezervës strategjike.

Në rastin se nuk do të ketë rezerve strategjike të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi atëherë  
A = TA.

$\alpha$  – janë koeficientët për ndarjen e të ardhurave të kërkuara ndërmjet kapacitetit të depozitimit, injektimit dhe tërheqjes së gazit natyror nga hapësirat e depozitimit. Operatori I sistemit të depozitimit do të përcjellë në aplikimin për tarifa përlogaritjen e këtyre koeficientëve bashkë me një benchmarking të këtyre koeficientëve të realizuar nga shërbimi depozitimit nga operatorë të ngjashëm që operojnë në rajon apo më gjërë.

S- është hapësira e kapacitetit vënë në dispozicion për depozitimin e gazit natyror prej Operatorit të Sistemit të Depozitimit

E – është hapësira e kapacitetit vënë në dispozicion për tërheqjen e gazit natyror prej Operatorit të Sistemit të Depozitimit

I – është hapësira e kapacitetit maksimal vënë në dispozicion për injektimin e gazit natyror prej Operatorit të Sistemit të Depozitimit në fillim të fazës së injektimit duke konsideruar dhe rastin e injektimit të të gjithë gazit natyror që do të shërbejë për rezervën strategjike në rastin se do të parashikohet një e tillë në kodin e depozitimit.

## **Neni 12**

### **Aplikimi për tarifë**

- 12.1 Bazuar në këtë metodologji, Operator i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror do të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se 6 muaj para hyrjes së tyre në fuqi.
- 12.2 Në aplikim, Operator i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror do të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat e nevojshme për kostot e aktivitetit të shërbimit të depozitimit.

## **Neni 13**

### **Kërkesat për Publikun**

- 13.1 ERE pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të tarifave të shërbimit të depozitimit, njofton palët e interesit në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”.
- 13.2 Operator i sistemit të Depozitimit të gazit natyror publikon tarifat e shërbimit të depozitimit të miratuara nga ERE 15 ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi, në përputhje me përcaktimet e pikës 8 të nenit 33 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar.

## **Neni 14**

### **Dokumentacioni**

- 14.1 Propozimi për tarifën e depozitimit të Operatorit të sistemit të depozitimit të gazit natyror duhet të përmbajë:
1. Paqyrat Financiare të Audituar.
  2. Një përshkrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e mbyllur ushtrimore si dhe:
    - a) shumën e të ardhurave të kërkuara TA;
    - b) përbërësit shtesë të të ardhurave nëse rezultojnë nga PF;
    - c) tarifat e referuara në nenin 11;
    - d) sasia e kapacitetit teknik të hapësirës së depozitimit, injektimit dhe tërheqjes së gazit natyror në hapësirën e depozitimit;

- e) arsyetimet dhe vlersimet mbi sigurimin e shërbimeve shtesë nëse parashikohet të ketë kosto përtej parashikimit lidhur me konsumin teknologjik dhe humbjet e gazit natyror lidhur me aktivitetin e depozitimit apo kosto të tjera që lidhen me aktivitetin e depozitimit të shoqëruara me dokumenta të justifikuar;
  - f) parashikimi i kostove lidhur me aktivitetin e shërbimit të depozitimit së bashku me të dhënat mbi kushtet e pritshme të funksionimit të hapësirës së depozitimit, të përcaktuara gjithashtu në bazë të të dhënave historike dhe supozimeve të tjera përkatëse të konsideruara për qëllimet e vlerësimit të tarifave të propozuara.
  - g) kriteret e përdorura për të bërë ndarjen e të ardhurave ndërmjet shërbimeve të depozitimit, injektimit dhe tërheqjes së gazit natyror si dhe koeficientëve që propozohen, të përcaktuara sipas nenit 11 të kësaj metodologjie.
  - h) listën e llogarive të aktivitetit të depozitimit të gazit natyror të ndara nga aktivitetet e tjera;
  - i) pasqyrat financiare për vitin e testimit si dhe të periudhës aktuale;
  - j) krahasimin e kostove të lejuara dhe atyre të realizuara;
  - k) çdo dokument justifikues të shpezimeve të jashtëzakonshme apo që nuk kanë natyrë përsëritëse.
3. Përshkrim të hollësishëm të ndërhyrjeve të planifikuara dhe koston e investimeve të ndara sipas kategorive të aseteve.
  4. Përshkrim të hollësishëm mbi investimet që priten të realizohen për rritje të kapacitetit të hapësirave të depozitimit, injektimit dhe tërheqjes së gazit natyror, kohën e vlerësuar për realizimin dhe vënien në operim të këtyre investimeve.
  5. Diferencën midis të ardhurave të lejuara dhe atyre të realizuara në fakt, për të mundësuar korrigjimin e të ardhurave në periudhën pasardhëse.

## **Neni 15**

### **Interpretimi**

Në rast se, një çështje nuk është trajtuar në këtë Metodologji, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.



**Neni 16**  
**Amendime të Metodologjisë**

Kjo metodologji është objekt rishikimi me vendim të bordit të ERE-s, në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar dhe sipas “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”.

**Neni 17**  
**Dispozita Përfundimtare**

17.1 Kjo Metodologji u miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr. 185 datë 21.07.2022.

17.2 Kjo Metodologji hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.